



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria e Arsimit
05 Nr.016-26832
Datë 11.06.2026

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Ligjit Nr.08/L-153 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, nenit 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) NR.03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, kërkesës së drejtorisë së IEFH "Fluturat" në Suharekë nr.65/26 të datës 09.06.2026, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

K O N K U R S

Për regjistrimin e fëmijëve në IEFH "Fluturat" në Suharekë
për vitin 2026/2027

Nr.	Emri i institucionit	Vendi	Grup-mosha	Nr. Fëmijëve
1	IEFH "Fluturat"	Suharekë	09-2 vjeç	13 fëmijë
		Suharekë	2-3 vjeç	3 fëmijë
		Suharekë	3-4 vjeç	5 fëmijë
		Mushtisht	3-5 vjeç	7 fëmijë
		Duhël	3-5 vjeç	15 fëmijë
		Sopijë	3-5 vjeç	13 fëmijë
		Gjinoc	3-5 vjeç	15 fëmijë
		Studençan	3-5 vjeç	20 fëmijë
		Samadraxhë	3-5 vjeç	16 fëmijë
		Bukosh	3-5 vjeç	17 fëmijë

Kriteret për regjistrimin e fëmijëve në IEFH "Fluturat"-Suharekë:

-Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Suharekës mund të regjistrohen në IEFH "Fluturat"- Suharekë sipas zonës së mbulimit dhe sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) NR.03/2022 -PËR PËRFSHIRJEN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË KOSOVË.

Dokumentacioni i nevojshem per aplikim:

1. Aplikacioni (merret dhe dorëzohet në zyrët e IEFH "Fluturat" në Suharekë),
2. Dokumenti personal i prindit apo kujdestarit ligjor (leternjoftimi ose pasaporta kopje)
3. Ekstrakti i lindjes se fëmijës;
4. Certifikata e vendbanimit
5. Për qiramarrësit-kontrata mbi qiranë.
6. Dëshmia e mjekut për gjendjen shëndetësore të fëmijës;
7. Dëshmi për vaksinimin e fëmijës(fletorja e shëndetit të fëmijës);
8. Vërtetimi i punësimit të prindërve ose kontrata e punës (kopje);
9. Pasqyra e trustit për 6 mujorin e fundit.
10. Numri i fëmijëve tjerë të vendosur në institucionet parashkollore përkatëse.

Dokumentet dorëzohen në IEFH "Fluturat" në Suharekë.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen jashtë afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur prej datës **15.06.2026** deri më date **29.06.2026**.

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani

